



UNIVERSITETI - UNIVERZITET - UNIVERSITY  
**HAXHI ZEKA**



# MENAXHIMI ME RISK - NOCIONI DHE FUNKSIONI I MENAXHIMIT ME RISK

Kapitulli 6

Ph.D. (c) Fisnik Morina

Mars, 2018

# MENAXHIMI I RISKUT

---

2

- Lënda: Menaxhimi i Riskut
- Viti III-të, Semestri VI, Departamenti: Kontabilitet dhe Financa
- Statusi i lëndes: Obligative
- Javët mësimore: 15 (2 orë ligjerata, 2 orë ushtrime)
- Prof. Asoc. Dr. Ibish Mazreku, Ph.D (c) Fisnik Morina
- Emaili: [ibish.mazreku@unhz.eu](mailto:ibish.mazreku@unhz.eu), [fisnik.morina@unhz.eu](mailto:fisnik.morina@unhz.eu)



# ZHVILLIMI HISTORIK I FUNKSIONIT TË MENAXHMENTIT ME RISK

---

3

- Menaxhimi me risk është praktikuar që nga koha e lashtë. Edhe njerëzit parahistorik janë grumbulluar së bashku në fise për të ruajtur resurset e tyre.
- I kanë ndare përgjegjësitë për të siguruar ndonjë mbrojtje nga pasiguria që në atë kohë e ka përcjellë jetën e tyre. Kështu që edhe sot secili njeri e praktikon jo formalisht menaxhimin me risk, qoftë ky menaxhim i vetëdijshëm apo i pavetëdijshëm.
- Për shembull, e vendosim rrypinë e sigurisë kur hyjmë në automobil që ta zvogëlojmë mundësinë e lëndimit serioze, përpiqemi që të ngremë ushqimin përkatës që ta mbajmë gjendjen e mirë shëndetësore.



# ZHVILLIMI HISTORIK I FUNKSIONIT TË MENAXHMENTIT ME RISK

---

4

- Ekzistojnë disa kundërthënie ne atë se a e kanë shpejtuar shkencëtarët zhvillimin e menaxhimit me risk apo megjithatë praktika afaristë i ka inspirua shkencëtarët, por nuk ka dyshime se periudha nga vitët 1955 deri 1964 ka qenë periudhë e lindjes se menaxhmentit modern me risk, dhe atë si nga pikëpamja akademike ashtu edhe ajo profesionale.
- Menaxhimi formal me risk ka ekzistuar edhe para kësaj periudhe, por termi “menaxhmenti i riskut” nuk ka qene zyrtarisht i pranuar krejt deri të kjo periudhë.



# ZHVILLIMI HISTORIK I FUNKSIONIT TË MENAXHMENTIT ME RISK

---

5

- Kështu që, deri në vitin 1929 e gjithë vëmendja ka qenë e orientuar në problemin e menaxhimit me riskun e pastër në një ndërmarrje.
- Atë vit blerësit e sigurimeve për ndërmarrje në mënyrë joformale janë takuar në Boston që ti shqyrtojnë problemet e përbashkëta.
- Asociacioni amerikan i menaxhereve në vitin 1931 ka themeluar njësinë e sigurimeve, që menaxherët të munden në mes veti ti këmbëjnë informacionet lidhur me blerjen e sigurimeve për ndërmarrje.
- Në New York në vitin 1932 është themeluar Shoqata e blerësve të sigurimeve, e cila më vonë është shëndrruar në Institut për hulumtimin e riskut.



# ZHVILLIMI HISTORIK I FUNKSIONIT TË MENAXHMENTIT ME RISK

---

6

- Në vetë fillimin e zhvillimit, menaxhmenti i riskut me supozimet e veta teorike se përveç sigurimit ekzistojnë edhe metodat tjera për menaxhimin e riskut, ka hasur në shumë rezistencë në rrethet e siguruesve.
- Kështu që, themelimi i shoqatës së blerësve të sigurimeve është pritur me skepticizëm nga ana e shoqërive të sigurimit, sepse ka ekzistuar frika se kjo shoqatë do të insistoi në ndonjë praktikë të re, të dëmshme për shoqëritë e sigurimeve.



# ZHVILLIMI HISTORIK I FUNKSIONIT TË MENAXHMENTIT ME RISK

---

7

- Sikurse edhe shumë funksione menaxheriale edhe funksioni i menaxhimit me riskun ka pasur funksionet e veta-më të rëndësishme.
- Ndoshta njëri nga funksionet më të rëndësishme të saj ka qenë blerja e sigurimit. Pozicionet më të shumta moderne të menaxhimit me risk ka rrjedhë prej funksionit të blerjes së sigurimit, dhe kjo periudhë historike, bile edhe sot, hedh hijen e gjatë edhe sot në nocionin e menaxhmentit të riskut.
- E njëjta mund të thuhet edhe për fushën akademike të menaxhmentit të riskut.



# ZHVILLIMI HISTORIK I FUNKSIONIT TË MENAXHMENTIT ME RISK

---

8

- Procesi evolutiv i cili blerjen e sigurimit e ka sjellë deri të menaxhmenti me risk nuk është zhvilluar as në mënyrë uniformë e as fazore por praktika vazhdimisht e ka ndryshuar në pajtim me nevojat.
- Shumë organizata nuk e kane asnjë person përgjegjës për menaxhim me risk apo për blerjen e sigurimeve, disa e kane vetëm përkohësisht të punësuar blerësin e sigurimeve, derisa të tjerat kanë programe të sotifikuara për menaxhment të riskut.
- Mirëpo, është e mundur të përshkruhet drejtimi i këtij procesi evolutiv.





# ZHVILLIMI HISTORIK I FUNKSIONIT TË MENAXHMENTIT ME RISK

---

9

- Menjëherë pas Luftës se Dytë Botërore shumica e organizatave që e kanë praktikuar në mënyrë formale menaxhmentin me risk apo sigurime, kanë pasur të punësuar njerëz përkohësisht apo të përhershëm të cilët janë marrë me blerjen e sigurimeve, përgjegjësi e të cilëve ka qenë që ta themelojnë dhe menaxhojnë portfolionë e sigurimeve dhe të aktiviteteve të tjera që kanë qenë të lidhura me sigurimet.
- Në kuadër të numrit të madh të këtyre organizatave këto aktivitete kanë filluar të zgjerohen paralel me zgjerimin e numrit të sigurimeve dhe me rritjen e kompleksitetit të pyetjeve të lidhura me blerjen e sigurimeve.



# ZHVILLIMI HISTORIK I FUNKSIONIT TË MENAXHMENTIT ME RISK

---

10

- Nocioni i menaxhimit me risk në praktikë dhe literaturë në pjesët e ndryshme të botës është lajmëruar në kohë të ndryshme.
- Në SHBA është lajmëruar në fillimet e viteve 60 të shekullit XX. Kështu menaxhmenti i riskut lajmërohet në literaturë “Risk management: A new Phase of Cast Control, Harward Business Review, 1956” dhe Robert I. Mehru, Bob A. Hedges: Risk management në ndër arritjen ekonomike, Homewood, Ilionis 1963”.



# ZHVILLIMI HISTORIK I FUNKSIONIT TË MENAXHMENTIT ME RISK

---

11

- Studimet e para të riskut kanë qenë shprehje e disa tensioneve të cilat deri atëherë kanë ndikuar në këtë fushë.
- Edhe pse në fillim është dukur se menaxhmentim me risk po evaluon kah koncepti i gjerë i menaxhmentit, organizatat edhe më tutje kanë pretenduar që menaxhmentin me risk ta shohin më shumë si nënfunkcion të financave, nga shkak i vetë natyrës së financave në vetë procesin e blerjes së sigurimit.
- Në nivelin e praktikës ky tension ka qenë me i dukshëm me rastin e vendosjes së vendit të menaxherit të riskut në nivel të organizatës.



# ZHVILLIMI HISTORIK I FUNKSIONIT TË MENAXHMENTIT ME RISK

---

12

- Edhe pse akoma sot jashtëzakonisht shumë shfrytëzohet sigurimi, organizatat më të mëdha e kanë reduktuar mbështetjen e tyre në aranzhmane konvencionale, sepse menaxherët e riskut e kanë zbuluar se sigurimi nuk i mbulon të gjitha nevojat specifike të organizatës së dhënë, apo se megjithatë disa aktivitete brenda vetë ndërmarrjes mund të kontrollojnë ndikimin e riskut dhe pasigurisë në organizatë.
- Për shembull, disa organizata shumë të mëdha kanë vërejtur se mund ti parashikojnë disa lloje të dëmeve aq mirë sa edhe vetë siguruesi, çka i ka shtyrë që të përcaktohen për vetësigurim të atij risku.



# ZHVILLIMI HISTORIK I FUNKSIONIT TË MENAXHMENTIT ME RISK

---

13

- Në mënyrë ironike, njëra nga fushat më me ndikim, inxhinjeringu i sigurisë, tek tani ka fituar njohje të plotë dhe është integruar në menaxhmentin e riskut.
- Menaxherëve të risku veq një kohë të gjatë iu është e ditur se cila është marrëdhënia e tyre inxhinjeringut të sigurisë.
- Mirëpo, bashkimi i këtyre dy funksioneve në një unike, tërësi kohëzive, nuk ka ndodhur në masë të madhe.
- Një pjesë e shpjegimit për këtë dukuri qendron në vetë strukturën organizative të shumica e ndërmarrjeve, të cilat kanë mundësuar rritje paralele, por jo të ndërlidhur, të këtyre dy funksioneve.



# FUNKSIONI I MENAXHMENTIT ME RISK SOT

---

14

- Nocioni menaxhment i riskut është tipike amerikane, edhe te ne përdoret ky termin edhe pse fjala qeverisje (drejtimi) me risk do të ishte adekuatë.
- Vet procesi i menaxhmentit me risk mund të shihet si grumbull i metodave të cilat përdoren në mënyrë fleksibile dhe së bashku.
- Ky në thelb është proces multi – diciplinarë në të cilin me qëllim të zgjidhjes së problemit teorik bashkërisht shfrytëzohen dijeni dhe disiplina të ndryshme. .



# FUNKSIONI I MENAXHMENTIT ME RISK SOT

---

15

- Në realitet, ky është proces sistematik për identifikimin, analizën dhe vlerësimin e riskut, respektivisht të mundësisë së ndodhjes së dëmit me të cilën ballafaqohet ndonjë organizatë apo individë, si dhe zgjedhjen e mënyrës më të mirë për përpunimin, respektivisht tretmanin e këtyre risqeve të mundshme, e në pajtim me qëllimet dhe aspiratat të organizatës apo individit të dhënë.
- Siç kemi thënë më herët rreziqet po shumëzohen dhe ndërlikohen me zhvillimin e teknologjisë dhe rritjen e standardit të përgjithshëm shoqërorë.



# FUNKSIONI I MENAXHMENTIT ME RISK SOT

---

16

- Menaxhimi me risk dallon nga menaxhimi me sigurime. Menaxhimi me sigurim nënkupton përdorimin e të gjitha teknikave të lidhura me sigurime dhe është kufizuar në fushën e atyre risqeve nga të cilët mund të sigurohemi.
- Kjo nuk do të thotë se sot sigurimet kanë rol me të vogël në kontrollin e riskut se më herët.
- Tani sigurimet zënë vend jo shumë të ndryshëm në menaxhimin e tërësishëm me riskun dhe ajo akoma përbën pjesë të rëndësishme dhe vitale të procesit të risk menaxhmentit.





# FUNKSIONI I MENAXHMENTIT ME RISK SOT

---


17

- Në fotografinë III – 1 është paraqitur zhvillimi i funksionit të riskut në firmë.
- Ky zhvillim i programit të menaxhimit me risqe deri të integrimi i plotë dhe kyçjen më të madhe të menaxhmentit të vjetër dhe me përvojë është mundësuar me përmirësimin e teknologjive të komunikimit dhe informacionit, me zhvillimin e instrumenteve financiare dhe të tregut dhe të sistemeve të avancuara, të sofistikuar dhe të lira të udhëheqjes së kontabilitetit si dhe me forcimin e infrastrukturës ndërkombëtare.



# FUNKSIONI I MENAXHMENTIT ME RISK SOT

18



# FUNKSIONI I MENAXHMENTIT ME RISK SOT

---

19

- Menaxhimi me risk është e rëndësishme për spektër të gjerë të industrisë, nga bizneset e vogla deri të kompanitë e mëdha të cilat punojnë në gjithë botën, prej organizatave të cilat aktivitetin e vet e kufizojnë në hapësirat e veta deri të ato të cilat aktivitetin e vet e kryejnë në hapësirën e hapur (hapja e tuneleve, urave etj.), prej atyre që prodhojnë produkte të parrezikshme deri të ato që prodhojnë produkte toksike apo eksplozive.



# FUNKSIONI I MENAXHMENTIT ME RISK SOT

20

- **H. Felix Kloman**, konsulent shumë i njohur në fushën e menaxhimit të riskut ka shprehur qëndrimin se pasi që po pretendohet me menaxhimin e “risqeve të sigurueshme” që risqet tjera të injorohen.
- Pikëpamja e tij të menaxhimit të riskut në masë të madhe bazohet në iden që menaxherët e riskut duhet të menaxhojnë në mënyrë “holistike” me të gjitha rreziqet në ndonjë organizatë. Kolmani e definon menaxhimin e riskut si disiplinë e cila duhet të jetoj me mundësinë që ngjarjet e ardhshme mund të jenë shkaktarë të dëmit.



# FUNKSIONI I MENAXHMENTIT ME RISK SOT

21

- **Yacov Y. Haimes**, profesor i inxhinjeringut dhe të shkencave aplikative në universitetin në Virxhini më herët ka shkruar për “menaxhimin total me risk”, koncept i cili është i ngjashëm me konceptin që e shpreui Kolman.
- Ai e definon menaxhimin e përgjithshëm me risk si “proces holistik sistematik, të bazuar në statistikë, i cili ndërtohet në vlerësimin formal dhe menaxhimin e riskut ....dhe i cili përpunon katër burime (sisteme) të dështimit në kuadër të kornizës hierarkike – të shumë qëllimta”.



# FUNKSIONI I MENAXHMENTIT ME RISK SOT

22

- Katër burimet e tij të dështimit janë: (1) dështimi i hardverit, (2) dështimi i softuerit, (3) dështimet e natyrës organizative, dhe (4) gabimi njerëzorë.
- Ai përjashton faktorët e jashtëm të gabimeve, me arsyetim se ato varen nga vetë sistemi.
- Kjo pikëpamje është në pajtim me parimet e menaxhimit me kualitetin e përgjithshëm dhe bukur shumë bazohet ne konceptët gjuhësore të menaxhimit me inxhinjering dhe operacione.



# FUNKSIONI I MENAXHMENTIT ME RISK SOT

23

- Pikëpamjen e tretë e jep **Neil Doherty**, menaxher i riskut korporativ. Ky interpretim më shumë bazohet në atë se si teoria moderne financiare e shef funksioninë e menaxhimit të riskut, respektivisht, se vendimet në menaxhimin e riskut janë vendime financiare dhe duhet të vlerësohen në raport me ndikimin e tyre në vlerën e firmës.
- Duke pasur parasysh se pikëpamja financiare mbështetet në disa supozime që kanë të bëjnë me tregun, atë në masë të madhe e përfaqësojnë korporatat e mëdha publike.



# FUNKSIONI I MENAXHMENTIT ME RISK SOT

---

24

- Një trend interesant është paraqitja e “menaxhimentit financiar me riskun” e cila nuk guxon të përzihet me rishikimin financiar të menaxhimit të riskut. Kjo formë e menaxhimit me riskun kryesisht ka filluar në qarqet bankare dhe investive, si qasje sistemore e qasjes me risqet e caktuara financiare, si janë risqet e kreditimit, të kurseve revizore, të transaksioneve dhe të investimeve.
- Edhe pse bankat ballafaqohen mjaft gjatë me riskun, mungesat e rregullave dhe nënshtrimi i rritur i ndikimit të valutave të huaja i ka shtyer bankat dhe organizatat tjera ndërkombëtare që në mënyrë agresive të ballafaqohen me këto rreziqe.





# FUNKSIONI I MENAXHMENTIT ME RISK SOT

---

25

- Menaxhimi financiar me riske ka të beje me identifikimin, analizën dhe mënyrën e menaxhimit me risqet financiare spekulative.
- Këto risqe përfshijnë:
  1. Riskun e çmimit të mallit,
  2. Riskun e kamatave,
  3. Riskun e kursit devizore.



# FUNKSIONI I MENAXHMENTIT ME RISK SOT

---

26

- Gjatë viteve nëntëdhjeta disa ndërmarrje kanë filluar që tërë problemin risqeve të pastra dhe spekulative ta vështrojnë në mënyrë holistike, duke shpresuar se do të kenë sukses ti ulin shpenzimet dhe të gjejnë zgjidhje më të mira për menaxhimin e riskut, ashtu që i kombinojnë mbulimet për të dyja llojet e riskut.
- Honeywell është kompania e parë e cila prej American International Group në vitin 1997 ka hyrë në programin të riskut të integruar.
- Kjo është metodë e cila në marrëveshjen e njëjtë e kombinon mbulesën për risqe të pastra dhe spekulative.



# FUNKSIONI I MENAXHMENTIT ME RISK SOT

---

27

- Me këtë program të integruar udhëheqë një person me çka mundësohet qasja e njëtrajtshme me risqe në mënyrë ekonomike.
- Për shembull, menaxheri i riskut mund të jetë i brengosur për shkak të dëmit të mundshëm në pasurinë e vetësiguruar derisa udhëheqësi i financave brengoset për shkak të dëmit e cila është pasojë e ndryshimit negativ të kursit revizorë.
- Asnjëra nga këto dy dëme, vetvetiu nuk do të thotë të shkaktoi dëm të madh për ndërmarrjen, mirëpo nëse ndodhin të dyja njëkohësisht mundë të shkaktojnë pasoja serioze.



# Detyrat e mundshme të funksionit të menaxhimit të riskut

28



# FUNKSIONI I MENAXHMENTIT ME RISK SOT

---

29

Të gjitha përpjekjet për të definuar menaxhmentin e riskut gjenden ne mes të dy skajshmërive:

1. Menaxhmenti i risku nënkuptohet si funksion përcjellës menaxherial ku të gjitha aktivitetet ndërmarrëse orientohen kah risqet e mundshme dhe me atë rast shqyrtohen dhe kontrollohen nga aspekti i pengesës së mundshme potenciale, që ndërmarrja të aftësohet që të udhëheqë me pengesat e tilla potenciale, dhe
2. Menaxhmenti i riskut është emër i ri për preventivën e njohur dhe të praktikuar në zvogëlimin e dëmeve.



# Ju faleminderit për vëmendje!

[ibish.mazreku, fisnik.morina@unhz.eu](mailto:ibish.mazreku, fisnik.morina@unhz.eu)

[www.unhz.eu](http://www.unhz.eu)

[www.unhz.weebly.com](http://www.unhz.weebly.com)



UNIVERSITETI - UNIVERSITY - UNIVERZITET

"HAXHI ZEKA"